



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni Pranveror

**Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport,
Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media**

Mbledhja nr. 53

Prishtinë, më 01.06.2012 ora 13:00.

Ndërtesa e Kuvendit, sala N – 302

PROCESVERBAL

**I mbledhjes së Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike,
Qeverisje Lokale dhe Media**

Në mbledhje morën pjesë : Idriz Vehapi, Eqrem Kryeziu, Enis Kervan, Xhevahire Izmaqu, Sadri Ferati, Teuta Haxhiu, Lirije Kajtazi, Ramë Vataj Jeton Svirca dhe Milivoje Stojanović Mungoi Afrim Kasolli.

Në mbledhje morën pjesë përfaqësues të OSBE-së, KE-së, përfaqësues dhe zyrtarët për media të Kuvendit.

Nga stafi mbështetës i komisionit : Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi, Idriz Vehapi, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky:

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, mbajtur me 29.05.2012;
3. Informatë e z.Slobodan Petrovic, Zëvendëskryeministër dhe Ministër i MAPL lidhur me Themelimin e Zyrës Administrative në Mitrovicën Veriore;
4. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua nga të pranishmit

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, mbajtur me 29.05.2012;

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 29.05.2012 u miratua pa ndryshime.

3. Informatë e z.Slobodan Petrovic, Zëvendëskryeministër dhe Ministër i MAPL lidhur me

Themelimin e Zyrës Administrative në Mitrovicën Veriore;

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kryetari ia dha fjalën ministrit të MAPL që të informoje komisionin me Vendimin e Qeverisë për themelimin e Zyrës Administrative në Mitrovicën Veriore.

Ministri i MAPL, Slobodan Petrovic në diskutimin e tij foli lidhur me rendësin e themelimit të Zyrës Administrative në Mitrovicën Veriore me qëllim të ofrimit të shërbimeve për qytetarët e Mitrovicës veriore. Ai tha themelimi i Zyrës Administrative në Mitrovicën Veriore përveç institucioneve më të larta të Kosovës, ka gjetur përkrahje edhe nga bashkësia ndërkombëtare, si ICO-ja, EULEX-i, KFOR-i dhe UNMIK-u.

Më tej ministri përmendi shpalljen e konkursit për vendet e punës së kësaj zyre e cila do të ketë 55 punonjës, ndërsa do të udhëhiqet nga drejtori ekzekutiv.

Ministri përmendi edhe interesimin e shumë qytetarëve të komunitetit serb dhe boshnjak për të aplikuar për këto vende pune dhe pritet që numri i konkurruesve të jetë edhe më i madh. Projekti që ka të bëjë me themelimin dhe punën e kësaj zyre u vlerësua si një fillim i mbarë, dhe shprehu besimin se qytetarët do të t' i drejtohen kësaj zyre, për kërkesa për dokumente e shërbime të tjera.

Me këtë rast ai tha se Ministria e Pushtetit Lokal në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe ministritë tjera do të jetë përgjegjëse për këtë çështje deri në themelimin e komunës së Mitrovicës veriore sipas Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale.

Kjo Zyre Administrative në Mitrovicën Veriore do të ndihmohet edhe nga komunat e tjera të Kosovës si dhe nga ministritë tjera.

Sadri Ferati në diskutimin e tij përmendi statusin që ka në këtë pjesë të qytetit të Mitrovicës e cila sipas tij paraqet pengesë për sundimin e ligjit.

Deputeti Ferati gjithashtu kërkoi sqarim nga ministri se sa është Ministria e Pushtetit Lokal e koordinuar me EULEX –in dhe BE –në, sa premtim Qeveria në çështjen e sundimit të ligjit, dhe kush do të vepron në këtë rast.

Teuta Haxhiu kërkoi sqarim lidhur me strukturën organizative të kësaj Zyre ku fitet për komunat rezervë dhe cilat do të jenë komunat rezervë në funksion të kësaj Zyre.

Eqrem Kryeziu tha se ky projekt paraqet një hap konkret përpara për një jetë të qetë dhe stabile të qytetarëve dhe për këtë qëllim duhet edhe ndihma e miqve ndërkombëtar.

Ramë Vataj kërkoi sqarim lidhur me pajisjen me dokumente të shtetësisë së Kosovës nga ana e qytetarëve serb të pjesës veriore të Mitrovicës.

Enis Kervan kërkoi sqarim lidhur me afatin kohor të ekzistencës së kësaj zyre, si dhe me kushtet për aplikim të qytetarëve për këtë Zyre, si dhe kërkoi të informohet lidhur me interesimin dhe numrin e anëtarëve të komunitetit jo serb për të aplikuar në këtë Zyre.

Xhevahire Izmaqi inkurajoi ministrin për punën dhe kërkoi informacion lidhur me sigurinë dhe prezencën e tij në pjesën veriore të Mitrovicës.

Deputeti Ferati kërkoi sqarim nga ministri lidhur me aspektin e sundimit të ligjit dhe besimit të qytetarëve të Mitrovicës për këtë çështje dhe vlerësoi se për këtë çështje ministri nuk dha informacion të duhur, andaj nuk e konsideroi si të mbyllur këtë çështje.

Kryesuesi i Komisionit vlerësoi se projekti që ka të bëjë me themelimin dhe punën e kësaj Zyre paraqet një fillim të mbarë, si nga instancat vendore dhe ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë.

4. Të ndryshme.

Mbledhja përfundoi në orën 14:40.

Përgatitur nga :

Njësia për Mbështetjen e Komisionit,

**Kryetari i Komisionit
Idriz Vehapi**